



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:267158

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05520325

P.nr.139/2023

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithsëm, Divizioni Penal, përmes gjyqtarit **Sadri Krasniqi**, me zytaren ligjore Donjeta Zenuni, në lëndën penale kundër të akuzuarve, G. D. nga për shkak të veprës penale: Falsifikimi i dokumentit nga neni 390 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. Donat Huruglica nga Gjilani, dhe i akuzuari B. M., nga për shkak të veprës penale: Falsifikimi i dokumentit nga neni 390 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. Abdylaziz Sadiku, duke vendosur sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani, PP.II.nr.1823/2023 të datës 19.12.2023, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e Marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, më datën 19.03.2024, në prani të Prokurores së Shtetit, Leonora Kadriu, të akuzuare G. D. dhe B. M. dhe mbrojtësin e tyre sipas detyrës zyrtare av. Donat Huruglica dhe av. Abdylaziz Sadiku, shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 28.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. B. M., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati R. dhe e ëma H., e lindur ..., i lindur më dt., në, ku edhe jeton, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i gjendjes të dobët ekonomike, sipas të dhënave të gjykatës i pa dënuar më parë dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër për vepër tjetër penale.

2. G.D., pa pseudonim dhe emër të rrejtshëm, nga i ati B. dhe e ëma Nevrije, e lindur Beqiri, i lindur më dt., në, ku edhe jeton, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i gjendjes të mesme ekonomike, sipas deklaratës së tij i pa dënuar më parë dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër për vepër tjetër penale.

Janë fajtorë

Sepse:

I akuzuari G. D.,

Nga data 18 Shtator 2023 deri më datë 23 Shtator 2023, i pandehuri G. D., në cilësi të personit të autorizuar të kompanisë transportuese “EU BUSS” SH.P.K, për linja ndërkombëtare ka falsifikuar – përpiluar policen e sigurimit me numër 108020828443, kinse e njëjta është lëshuar nga Byroja Kosovare e Sigurimeve, në atë mënyrë që së bashku me dokumentet tjera ia jep për ta përdor B.M.- shoferit i autobusit me targa, me numër NIA, ashtu që me datë 23 Shtator 2023, derisa shoferi B. M., kishte qenë duke kaluar pikën kufitare “Dheu i Bardh” pas kontrollimit të dokumenteve nga ana e policisë kufitare dhe pas verifikimit nga Byroja Kosovare e Sigurimeve, ia sekuestrojnë policën me numër të lartshënuar me vlefshmëri nga data 18 Shtator 2023 deri më 02 Tetor 2023, pasi që e njëjta kishte një numër serik më pak dhe tek minutat e shtypjes ka shpërputhje, dhe si i tillë nuk është shtypur e as nuk figuron në sistemin e BKS, me c’rast i pandehuri me vetëdije të njëjtën e ka përpiluar dhe e ka vënë në përdorim si të vërtetë, duke e vënë në rrezik qarkullimin juridik të dokumenteve.

- Me çka ka kryer veprën penale, falsifikimi i dokumentit nga 390 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

II.

I akuzuari B. M.,

Më datë 23 Shtator 2023, rreth orës 16:00 h, në hyrje të pikës kufitare “Dheu i Bardhë”, i pandehuri B. M., me dashje ka përdorur si të vërtetë policën e sigurimit me nr. 10802082843, që ishte e falsifikuar, në atë mënyrë që derisa i pandehuri kishte qenë duke drejtuar autobusin me targa, me nr. të, për linjë ndërkombëtare, e të cilin autobus e kishte marrë me qira kompania “EU BUSS” SH.P.K, ashtu që pas kontrollës së dokumenteve nga ana e policisë kufitare, dyshohet se polica e sigurimit me numër 10802082843, me

vlefshmëri nga data 18 Shtator 2023 deri më 02 Tetor 2023, është e falsifikuar dhe pas verifikimit nga Byroja Kosovare e Sigurimeve, policia e sigurimit me numër të lartshënuar, konstatohet se kishte një numër serik më pak dhe tek minutat e shtypjes ka shpërputhje, dhe si i tillë nuk është shtypur e as nuk figuron në sistemin e BKS, e me që e njëjta është e falsifikuar, sekuestrohet nga policia kufitar, me c'rast i pandehuri me dijeni dokumentin e falsifikuar e ka përdorur si të vërtet, duke e vë në rrezik qarkullimin juridik të dokumenteve.

-me çka ka kryer veprën penale, falsifikimi i dokumentit nga neni 390 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u mbështetur në nenin 4, 38, 42, 43, 44, 69, 70, 71 dhe 76 paragrafi 2 nën par.2.4, të KPRK-së, lidhur me nenin 230, 276 paragrafi 2 pika 2.6, 364 dhe 449 të KPPRK-së, të akuzuarit i,

G J Y K O N

Me dënime kumulativ, edhe ate:

Të akuzuarin **B. M.**, me dënim me gjobë (të holla) në shumë prej 200 € (dyqind euro), dhe me dënim burgu efektiv në kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit, e në kuptim të nenit 44 të KPRK-së do t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 500 €,

-Konform dispozitave ligjore të nenit 76 par.2 nën par.2.4 të KPRK-së, të akuzuarit i shqiptohet dënim **unik me gjobë** në shumë prej **shtatëqind (700) euro**, të cilën shumë ka për ta paguar duke filluar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në këste mujore, në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu, ashtu që për çdo 20 € do t'i llogaritet nga një ditë burgu,

Në bazë të nenit 276 paragrafi 2 pika 2.6 të KPPRK-së të akuzuarit i **KONFISKOHET** polica e sigurimit me numër 10802082843, dhe e njëjta do të dorëzohet për ruajtje në zyrën për Corpus delikte të kësaj gjykate.

Të akuzuarin **G. D.**, me dënim me gjobë (të holla) në shumë prej 200 € (dyqind euro) dhe dënim burgu efektiv në kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit, e në kuptim të nenit 44 të KPRK-së do t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 500 €,

-Konform dispozitave ligjore të nenit 76 par.2 nën par.2.4 të KPRK-së, të akuzuarit i shqiptohet dënim **unik me gjobë** në shumë prej **shtatëqind (700) euro**, të cilën shumë ka për ta paguar duke filluar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në këste mujore, në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu, ashtu që për çdo 20 € do t'i llogaritet nga një ditë burgu.

-OBLIGOHEN të akuzuarit, që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu të akuzuarit obligohen që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguajnë shumën prej nga 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.1823/2032, të datës 19.12.2023, i ka propozuar gjykatës që ndaj të akuzuarve, G. D. nga fshat..... dhe i akuzuari B. M., nga, për shkak të veprave penale: Falsifikimi i dokumentit nga neni 390 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit. Së bashku me aktakuzën Prokuroria e Shtetit ka parashtruar dhe Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë së hartuar nga ana e Prokurorisë së Shtetit - Prokuroria Themelore në Gjilan, në njërën anë dhe të akuzuarit G. D. me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. D.t H., të akuzuarit B. M. me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av.A.S., në anën tjetër.

Në marrëveshjet për pranimin e fajësisë të hartuara ndërmjet palëve, respektivisht Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe të akuzuarve me mbrojtësit e tyre, palët kanë përcaktuar edhe kushtet e pranimit të fajësisë, ku ndër të tjera janë negociuar dhe propozuar dënimet me gjobë prej nga 200 € dhe dënimet me burgim prej nga gjashtëdhjetë (60) ditëve, të cilët dënime me pëlqimin e të akuzuarve, konform nenit 44 të KPRK-së do t'iu zëvendësohen në dënime me gjobë në shumë prej nga 500 euro.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe marrëveshjet për pranimin e fajësisë, pas vlerësimit të së njëjtave dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se të njëjtat janë të bazuara në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtave, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtimin e marrëveshjeve për

pranimin e fajësisë kundër të akuzuarve për datë 19.03.2024, në të cilën seancë gjyqësore, Prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës PP.II.nr.1823/2023, të dt. 19.12.2023, kundër të akuzuarve B. M. dhe G. D., për shkak të veprës penale, Falsifikimi i dokumentit nga neni 390 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe Marrëveshjeve për pranimin e fajësisë të datës 16.02.2024, e lidhur në Prokurorinë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, nga fakti se të akuzuarit në prezencën e mbrojtësit të tyre av. A. S. dhe av.D.H., në mënyrë vullnetare pa shtrëngim apo nën presion në tërësi kanë pranuar benefitet dhe pasojat e këtyre marrëveshjeve.

Marrëveshjet për pranimin e fajësisë PP.II.nr.1823/2023, janë hartuar më datë 16.02.2024 në mënyrë vullnetare nga të pranishmit dhe të pranuar nga të akuzuarit B.M. dhe G.D., në tërësi si marrëveshje me të gjitha pikat dhe konditat e tyre.

I akuzuari B. M. dhe mbrojtësi i tij av.A.S., deklarojnë se në tërësi mbesin pranë marrëveshjes së nënshkruar dhe pranuar nga i akuzuari dhe njëkohësisht i propozuan gjykatës që ta aprovoj në tërësi marrëveshjen me të gjitha elementet - kushtet e saj.

I akuzuari G. D., dhe mbrojtësi i tij av.D. H. deklarojnë se në tërësi mbesin pranë marrëveshjes së nënshkruar dhe pranuar nga i akuzuari dhe njëkohësisht i propozuan gjykatës që ta aprovoj në tërësi marrëveshjen me të gjitha elementet - kushtet e saj.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga të akuzuarit, respektivisht nga vetë përmbajtja dhe kushtet e pranimin të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, ku të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen.

Gjykata, sipas detyrës zyrtare e në harmoni me nenin 251 të KPPRK-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa-pranueshme dhe e marrë në kundërshtim me dispozitat e nenit të lartë-theksuar e cila do të vinte në mëdyshje dhe do të bënte të papranueshëm pranimin e fajësisë. Gjithashtu, gjykata konsideroi se nuk ekzistojnë rrethana të përcaktuara nga neni 244 të KPPRK-së të cilat do të konsistonin në krijimin e situatës dhe rrethanave për hedhjen e aktakuzës.

Gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën-pasojat e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë për veprat penale të cilat iu vihen në barrë. Marrëveshjet për pranimin e fajësisë, respektivisht pranimi i fajësisë nga të njëjtit është bërë në mënyrë vullnetare, pa kushtëzim, pa presion, askush nuk ia ka bërë ndonjë premtim të kundërligjshëm i cili do ti shtyjë në pranimin e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, heqin dorë nga e drejta në gjykim të rregullt, respektivisht nga të gjitha të drejtat që kanë të bëjnë me gjykimin e rregullt, pas konsultës së

mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe në harmoni me dispozitat e neneve 230, 240 dhe 242 të KPPRK-së.

Ndërsa sa i përket dënimit dhe vendimit për dënimin, Prokurorja e Shtetit, Leonora Kadriu, i akuzuari B.M. dhe mbrojtësi i tij av.A.S., i akuzuari G.D. dhe mbrojtësi i tij av.Donat Huruglica, i propozuan gjykatës që ti aprovoj dënimet e përcaktuara në marrëveshjet për pranimin e fajësisë.

Gjykata duke marrë në konsideratë rrethanat të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, respektivisht rrethanat e përcaktuara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, erdhi në përfundim se dënimet e propozuara nga palët janë dënime të cilat i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë penale të tyre-akuzuarve dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen të akuzuarit të jetë më të përgjegjshëm dhe të përmbahen nga veprimet e këtilla.

Gjatë vendosjes për dënimet, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana tejet lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, ku këtë gatishmëri të pranimit të fajësisë të njëjtit e kanë shprehur që në fazat e hershme hetimore me lidhjen marrëveshjeve për pranimin e fajësisë.

Andaj, bazuar në rrethanat e lartë-theksuara gjykata ka aprovuar marrëveshjet për pranimin e fajësisë në tërësi me të gjitha elementet e tyre, respektivisht ka aprovuar dënimet me gjobë prej nga 200 € dhe dënimet me burgim prej nga gjashtëdhjetë (60) ditëve, të cilët dënime me pëlqimin e të akuzuarve, konform nenit 44 të KPRK-së do t'iu zëvendësohen në dënime me gjobë në shumë prej 500 euro, dënim i cili ka për tu ekzekutuar pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Andaj bazueshëm mund të pritet që këto dënime do të ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e të akuzuarve, do të kenë ndikim edukativ edhe ndaj qytetarëve tjerë që në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale, sikundër që do t'i kontribuojnë disiplinës dhe përgjegjësisë më të madhe të qytetarëve në përgjithësi.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarve, gjykata, bazuar në nenin 452 paragrafi 1 KPP-së-së, ka vendosur që të akuzuarit ti detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 € (Njëzetë euro), si dhe nga 20 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2023:267158, 28.03.2024

G j y q t a r i,

Sadri Krasniqi,d.v.

Këshilla Juridike : Ky aktgjykim është i plotfuqishëm që në datën e shpalljes-publikimit të tij, pasi që palët kanë hequr dorë nga e drejta e ushtrimit të ankesës ndaj të njëjtit.